



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3224_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 30 par. 1 të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Nr. 08/L-258); Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; Nenin 3, 4, 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtrishme të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **399 kW**, e pranuar me datë 12.05.2026 nga aplikuesi personi juridik "BINNI" SH.P.K., me adresë: "Dumnica" Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 18 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M

PËR MODIFIKIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** – kërkesa e aplikuesin "BINNI" SH.P.K., për Modifikimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, Jashtë Skemës Mbështetëse me kapacitet të instaluar prej **200 kW ekz. + 199 kW shtesë = 399 kW** në Komunën e Vushtrrisë.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "BINNI" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DMI - 9024367 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "BINNI" SH.P.K., sipas pikën I. të këtij Vendimi, pas marrjes së autorizimit për ndërtim është i detyruar që brenda afati prej tridhjetë (30) ditëve të dërgojë në ZRRE kontratën e nënshkruar me furnizuesin, ndër të tjera duke përfshire edhe menaxhimin e tepricave, pa i zbuluar informatat konfidenciale, në pajtim me Nenin 8 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtrishme.

A r s y e t i m


- o ZRRE, me datë 12.05.2026 nga aplikuesi "BINNI" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për modifikimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **200 kW ekz. + 199 kW shtesë = 399 kW** në Komunën e Vushtrrisë.





- Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 4072 të datës 23.03.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 11224/26 të datës 16.04.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "BINNI" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për marrjen e statusit të prosumtorti dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **200 kW ekz. + 199 kW shtesë = 399 kW** në Komunën e Vushtrrisë, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi V_2707_2025 të datës 30 prill 2025 i lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Vushtrrisë,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.